



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al

e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

V E N D I M

Nr. 18, datë 24.3.2017

Për miratimin e shpërblimit për atletin Izmir Smajlaj, fitues i kampionatit Ballkanik, kampionatit European në kërkim së gjati në salla të mbyllura si dhe rekord kombëtar, dhe për trajnerin z. Vildan Tufi për mbështetjen e dhënë ndër vite për ekipin e atletikës

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 24.3.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr 9376, datë 21.4.2005 "Për Sportin", i ndryshuar, VKM nr. 1720, datë 29.10.2008 "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajnimit për përgatitjen sportive", i ndryshuar, VKB nr 8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017", pas diskutimeve,

V E N D O S I :

1. Miratimin e fondit prej **500,000** (pesëqind mijë) lekë, si shpërblim për atletin **Izmir Smajlaj**, kampion Ballkani dhe kampion Europe në kërcim së gjati në salla të mbyllura, Mars 2017.
2. Burimi i financimit është buxheti i bashkisë Shkodër për vitin 2017 të miratuar me VKB nr 8, datë 30.1.2017, përfshirë në aktivitetin P12, F1, O1, A11 "shpërblim për ekipet kampion", të institucionit bashkia Shkodër në programin 8140 "Për Sportin", zëri "transferime individuale"
3. Miratimin e fondit prej **100,000** (njëqind mijë) lekë, si shpërblim për trajnerin e atletikës **z. Vildan Tufi**, për kontribut ndër vite pranë SportKlub Vllaznia.
4. Burimi i financimit është fondi rezervë i bashkisë Shkodër, miratuar me VKB nr. 8, datë 30.1.2017.
5. Institucionit Bashkia Shkodër në programin buxhetor 08140 "zhvillimi i sportit" t'i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 100,000 (njëqind mijë) lekë, shpenzime

korrente, artikulli 606 "transferta tek individë", për t'u përdorur për trajnerin z. Vildan Tufi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 24.3.2017

Shpallur në datën 24.3.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

Zv/ KRYETAR



Gaspër KOKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKT

Prot. 4693 07.04.17

Nr.360/1 Prot

Shkodër, më 5.4.2017

Lënda: Lidhur me vendimin e këshillit bashkiak Shkodër nr.18 datë 24.03.2017.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin", ligjit nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", nenet 3, 4, 9, 10, 22, 25, 34,40, neni 54, germa dh, neni 55/3, 64/c, ligjit nr.130/2016 "Per buxhetin e vitit 2017", Udhezimit te Ministrit te Financave Nr.8 dt.13.01.2017 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2017", Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH", neni 17 i ndryshuar, ligjit nr.9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" i ndryshuar neni 8, Udhezimit nr.2 dt.6.02.2012 "Për procedurat standarte te zbatimit te buxhetit" i ndryshuar, VKM nr.1720/2008 "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", shqyrtoi vendimin e këshillit bashkiak Shkodër nr.18 datë 24.03.2017 "Për shpërblim të atletit Izmir Smajlaj, kampion Ballkani dhe kampion Europe në mars 2017 në shumën prej 500.000 lekë me burim financimi P.12, F1, O1, A11, prog.buxhetor 08140 dhe trajnerin z. Vildan Tufi në shumën prej 100.000 lekë, me burim financimi fond rezervë 2017" Prefekti ju autorizon të procedoni, si një kampion-qytetar i bashkisë Shkodër, i cili ka lartësuar imazhin e mirë të qytetit të Shkodrës dhe Shqipërisë.

Me respekt,

PREFEKTI

